



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2016

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtuar: **Subjekti “KLIMA TEKNIKA TB2” sh.p.k.**

NIPT: K49322506W

Adresa: Lagjja 11 Janari, ndërtesë private, pranë fushës së vjetër të sportit, zona kadastrale nr. 8541, numër pasurie 3/17

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kondicionerë dhe pasjisje elektro-shtëpiake për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“KLIMA TEKNIKA TB2” sh.p.k.**, me NIPT K49322506W dhe vlerë **2.635.900** (dy milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind) **lekë (pa TVSH)**.
2. **“PAERA” sh.p.k.**, me NIPT L31505034R, i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“SULOLLARI” sh.p.k.**, **“ALBIOLA” sh.p.k.**, dhe **“MONTELA” sh.p.k.**, të përfaqësuar nga subjekti **“SULOLLARI” sh.p.k.** me NIPT K01529003M dhe vlerë **2.448.000** (dy milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë) **lekë (pa TVSH)**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“PAERA” sh.p.k**
2. **“SULOLLARI” sh.p.k**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "PAERA" sh.p.k. është skualifikuar për arsye se nuk ka paraqitur asnjë prej dokumenteve të kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, por ka paraqitur vetëm një Certifikatë regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dokument i cili nuk i është kërkuar.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "SULLOLLARI" sh.p.k., "ALBIOLA" sh.p.k. dhe "MONTELA" sh.p.k. skualifikohet për arsye të mospërmbushjes së kritereve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor, përkatësisht:
 - Bilanci i vitit 2013 dhe i vitit 2014, të paraqitur nga subjekti "SULLOLLARI" sh.p.k., nuk përmbajnë vulën e administratës tatimore në disa prej faqeve të tyre.
 - Bilanci i vitit 2014 dhe i vitit 2015, të paraqitur nga subjekti "ALBIOLA" sh.p.k., në asnjë prej faqeve të tyre nuk përmbajnë vulën e administratës tatimore.
 - Bilanci i vitit 2013, i vitit 2014 dhe i vitit 2015, të paraqitur nga subjekti "MONTELA" sh.p.k., në asnjë prej faqeve të tyre nuk përmbajnë vulën e administratës tatimore.
 - Subjekti MONTELA sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratë për gjendjen financiare, sipas përqindjes së kontribuimit të përcaktuar në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, në zbatim të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 74, pika 3.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin "KLIMA TEKNIKA TB2" sh.p.k. se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2.635.900 (dy milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind) lekë (pa TVSH)** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Universitetit të Mjekësisë, Tiranë* kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.11.2016

Ankesa: PO

Nga operatori ekonomik **“SULLOLLARI” sh.p.k.** më datë 31.10.2016 dhe ka marrë përgjigje më datë 03.11.2016.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

REKTOR

Prof. Dr. Arben GJATA

